

VENDIM

NR. 2 DATE 25 QERSHOR 2006
ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE
" VAGALATI " SH.P.K.



Ne Seline e Shoqerise " VAGALATI " shpk u zhvillua mbledhja e Ortakut te vetem te Shoqerise per të shqyrtuar situaten financiare të shoqerise dhe mundesine e rritjes se kapitalit themeltar te nenshkruar te shoqerise " VAGALATI " shpk, nepermjet rikapitalizimit te fitimit te akumuluar dhe te pashperndare nga ana e shoqerise gjendje te dates 31.12.2005 dhe ne perfundim,

V E N D O S A

Miratimi i raportit te paraqitur nga ekspertja kontabel e autorizuar, per rritjen e kapitalit themeltar te nenshkruar te shoqerise " VAGALATI " shpk, nepermjet rikapitalizimit te fitimit te akumuluar dhe te pashperndare nga ana e shoqerise gjendje te dates 31.12.2005. Zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise " VAGALATI " shpk, sipas menyres se percaktuar ne raportin e ekspertit kontabel te autorizuar.


Zmadhimi i kapitalit themeltar te shoqerise " VAGALATI " shpk, nga 100.000 leke (njeqind mije) ne 10 300 000 (dhjete milione e treqind mije) leke .

Vlera nominale e kuotave te kapitalit pas rritjes se kapitalit behet nga 1000 leke ne 103 000 leke.

- Depozitimimi e ketij vendimi prane Zyres se Regjistrimit Tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Ne baze te ligjit 7667 date 28.01.1993 " Per Regjistrimin Tregtar dhe Formalitetet qe duhe respektuar per Shoqerite Tregtare ", kerkojme nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, qe te behet i mundur depozitimi i ketij vendimi, prane Zyres se Regjistrimit Tregtar dhe nenvizimin e ndryshimeve perkatese ne skeden e shoqerise sipas ligjit.

Ortaku i vetem



DHOMA E NOTEREVE TIRANE

NR. 5160 **REPERTORI**

NR. 1368 **KOLEKSIONI**

VERTETIM


Ne Tirane sot me date 27 qershor 2006 , para meje noteres Manushaqe Sharka , me seli ne bulevardin “ Gjergj Fishta” prane Gjykates se Rrethit Tirane, m’ u paraqit personalisht shtetasi : **Sefer Hoxha** , i biri i Jonuzit dhe Azizes , i datelindjes 12 dhjetor 1966, lindur ne Tepelene dhe banues ne Tepelene , madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifkjar me pasaporten nr. Z 1788923 , i cili nenshkroi para meje noteres sa me siper.

Une noteri vertetoj rregullsine dhe bazueshmerine dhe autenticitetin e nenshkrimit te ketij akti , me cilesine qe me njej ligji nr. 7829 date 01.06.1994 per noterine.

NOTER
Manushaqe Sharka



A handwritten signature in black ink, appearing to be "Manushaqe Sharka".



RAPORT


I EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR PER ZMADHIMIN E KAPITALIT THEMELTAR

TE SHOQERISE

“ VAGALAT “ SH.P.K. TEPELENE

Tepelene 21 qershor 2006

Raporti vlen vetem per auditimin ligjor, 2005



**RAPORTI I EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR PER ZMADHIMIN E
KAPITALIT THEMELTAR TE SHOQERISE " VAGALAT" SH.P.K.**

Te nderuar zoterinj!

Une kam nderin t'iu raportoje nepermjet ketij raporti, punen e bere per shoqerine tuaj sipas objektit qe kam deklaruar ne deklaraten e marrjes se misionit dhe emerimin e bere nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

OBJEKTI

Pergatitja e raportit mbi verifikimin e gjendjes financiare ne shoqeri, fitimin e vitit ushtrimor 2005 si dhe zmadhimin e kapitalit te nenshkruar te shoqerise " VAGALAT" sh.p.k.

Ne permbushje te objektit ne kemi verifikuar GJENDJEN FINANCIARE TE SHOQERISE, FITIMIN E VITIT USHTRIMOR 2005 si dhe perdorimin e fitimit te vitit ushtrimor 2005 ne kontribute te hyra ne shoqeri sipas nevojave te ndryshme.

Ne kemi verifikuar ne menyre analitike faktoret qe na bindin qe ne te vertetojme keto kontribute te perfituara dhe qe jane active te shoqerise.

Shuma e fitimit qe rezulton ne fund te vitit ushtrimor 2005 eshte 10 224 670,88 leke, te cilat jane perdorur per qellimet e meposhteme :

- Per investim
- Per inventar ekonomik
- Per likujdim te furnitoreve te shoqerise
- Per shpenzime operative.

Ortaku i vetem ka vendosur ta rikapitalizojte kete fitim qe eshte perdorur nga shoqeria per kontribute te ndryshme.

Ne verifikuam regjistrat kontabile dhe bilancin e shoqerise se shoqerise tregtare " VAGALAT " sh.p.k. per vitin 2005, i cili eshte audituar nga une ekspertja kontabile e autorizuar dhe u konstatua se kjo shoqeri ka nje fitim per vitin ushtrimor ne shumen 10 224 670,88 leke.

Qe ne fillim te veprimtarise se saj shoqeria " VAGALAT " sh.p.k. ka operuar ne perputhje me objektin e veprimtarise se saj sic eshte percaktuar ne statutin e kesaj shoqerie dhe ne vendimin e regjistrimit prane Gjykates Tirane.

Shoqeria per te zhvilluar aktivitetin e saj financiar ka perdorur fitimin e ushtrimit per qellime te ndryshme per shtimin e aktiveve te shoqerise dhe zhvillimin normal te aktivitetit te saj.

Me fitimin e ushtrimit eshte investuar, duke financuar blerje dhe krijuar aktive te qendrueshme qarkulluese te cilat jane vene ne dispozicion te aktivitetit te shoqerise, dokumentat justifikuese mbi te cilat ne jemi mbeshtetur per t'u shprehur per perdorimin e fitimit jane ne dispozicion te shoqerise.

Sipas normatives se te drejtes shqiptare qe paraqitet ne vijim, dhe ne vecanti asaj mbi Shoqerite Tregetare, mbi Kontabilitetin, Planin Unik Kontabel dhe ne te njejten linje me standartet Nderkombetare te kontabilitetit, eshte e drejta e asamblese se jashtezakoneshme qe te vendose te rikapitalizoje fitimin e akumuluar dhe ate te ushtrimit.

Me cilesine e ekspertit kontabile te dhe ne baze te verifikimeve te bera, mbeshtesim vendimin e asamblese se ortakeve per rikapitalizimin e fitimit duke vertetuar eshe perdorimin e tij ne krijimin e aktiveve te shoqerise.

Shoqeria per viti 2005 ka pasur nje fitim 10 224 670,88 leke .

Ajo me vendim te saj ka sistemuar fitimin e ushtrimit si me poshte : 10 065 600,88 leke fitimi i mbartur dhe i vitit dhe 159 070 leke per rezerve ligjore. Shuma totale del 10 224 670,88 leke. Per ekzekutimin e mandatit te marre nga ana juaj ne lidhje me zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise " VAGALAT " sh.p.k. jemi mbeshtetur dhe kemi ne dispozicion dokumentet e mepostheme :

- Bilancin ku pasqyrohet situata kontabile gjendje e shoqerise me date 31 dhjetor 2005, ne vecanti aktivitet dhe pasivit ne kete date dhe rezultati i vitit 2005.
- Raportin e ekspertit kontable te autorizuar.
- Dokumentet ligjore te shoqerise .
- Dokumentat justifikuese per perdorimin e fitimit.
- Vendimin nr. 01 date 14 qershor 2006 te asamblese se ortakeve te shoqerise " VAGALAT" sh.p.k.per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise.
- Vendimin nr. 12103/1 date 30.06.2006 te Gjyqtarit te vetem te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.
- Ligjin nr. 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregetare"
- Ligjin nr. 7661 date 19.01. 1993 " Per kontabilitetin"
- Planin unik kontabile te vitit 1993.
- Dokumenta te tjera .

Ne perfundim cmojme se :Kapitali i nenshkuar dhe i shlyer i shoqerise " VAGALAT" sh.p.k. ka gene 100 000 leke.

Me miratimin e ketij raporti nga asambleja e ortakeve gjithe shuma e kredise do te perdoret per zmadhimin e kapitalit dhe fitimi i vitit ushtrimor do te rikapitalizohet, atehere shoqeria do te shtoje kapitalin e saj me shumen 10 200 000 leke .

Krijohet rezerva ligjore ne shumen 24 670,88 leke, e cila vjen si rezultat i sistemimit te fitimit te mbartur dhe atij ushtrimor.

Ne perfundim mund te shprehemi se :

Kapitali i nenshkuar i shoqerise " VAGALAT " sh.p.k. nga vlera 100 000 leke shkon ne vleren 10 300 000 (dhjete milione e treqind mije) leke i perbere nga 100 pjese me vlere 103 00 leke secila kuote.

Bashkengjitur ju paraqesin bilancin e shoqerise per vitin ushtrimor 2005.

EKSPERT KONTABILE I AUTORIZUAR

Stoli Laze

Tepelene

